



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0008

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse me numër të prokurimit 207-25-11429-2-1-1, me 04/03/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K. me nr. 2026/0008, e datës 05/01/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse me numër të prokurimit 207-25-11429-2-1-1.
2. **Anulohet** ne teresi aktiviteti i AK të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse me numër të prokurimit 207-25-11429-2-1-1 kthehet në **Ritender**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.12.2025 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit Materiali

shpenzues dhe pajisje speciale mjekesore me numër të prokurimit 242-25-9414-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **sherbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **750,000.00€**.

Me 29.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 30.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.01.2026, OE " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0007, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për kontratë.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK me datën 22.12.2025 në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Njoftimit për Kontrate, Dosjen e Tenderit dhe Listën e Çmimeve.

Pas kemi shkarkuar dhe analizuar këto dokumente kemi vërejtur së Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK gjate hartimit të këtyre dokumenteve dhe zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bere shkelje substanciale të dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Me datën 29.12.2025 në ora 15:56 përmes platformës së E-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të AK – MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK.

AK - MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK më datën 30.12.2025 ora 10:23 në platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Vendimit për Pezullim të Aktivitetit të Prokurimit dhe menjëherë me datën 30.12.2025 në ora 10:53 - pas 30 minutave që ka bere publikimin e pezullimit përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim.

Bazuar në Përgjigjen - Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim shihet së Zyrtaret Përgjegjës të AK, qëllimisht i kane anashkaluar faktet dhe argumentet që ne kemi shënuar në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 29.12.2025.

Pretendimi 1:

Shkelje nenit 27 dhe 38 të LPP si dhe shkelje e neni 17 dhe 54 të RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK këtë aktivitet të prokurimit është duke e zhvilluar në kundërshtim të plote më nenin 27 dhe 38 të LPP dhe nenit 17 dhe 54 të RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Faktet dhe argumentet së pse ne konsiderojmë kështu janë:

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në Njoftimin për Kontrate ka shënuar :

Të neni II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës :

“Qëllimi i kontratës publike kornizë është që të përcaktohen kushtet që rregullojnë furnizimin me avio-bileta nga Operatori Ekonomik (shih Aneksin 1 për përshkrimin e sasive të parashikuara që mund të dorëzohet gjatë kohëzgjatjes së kontratës publike kornizë)”.

Me këtë përshkrim vete AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK dëshmon së kemi të bëjmë me Kontrate Publike Kornize .

Të neni II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë

Dëshmon së Autoriteti Kontraktues nuk ka specifikuar Krijimin e kontratës publike kornizë

Të neni II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Dëshmon së Autoriteti Kontraktues nuk ka specifikuar Kontrate publike kornizë me një operator

Të neni II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM ka shënuar :

“Kohëzgjatja në muaj 36”

Gjithashtu në Dosjen e Tenderit të Aneksi nr. 1- SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME ka shënuar –

“Gjatë periudhës 3 vjeçare numri i përafërt i biletave do të jetë 2000 copë në destinacione të ndryshme të botës. Kontrata konsiderohet e realizuar në bazë të sasive të biletave dhe jo vlerës.”

Edhe me këtë përshkrim në Aneksin nr,1 të Dosjes së Tenderit , vete AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK dëshmon së kemi të bëjmë me Kontrate Publike Kornize .

Në Listën e Çmimeve ka shënuar:

“Vlera e biletës prej € 355.00 është një vlerë e paragjykuar që shërben vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës. Çmimi real do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO,

SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm ose sisteme online. Kontrata do të bazohet në sasi.”

Edhe me këtë përshkrim në Listën e Çmimeve, vete AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK dëshmon se kemi të bëjmë me Kontrate Publike Kornize

Të gjitha këto të dhëna të shënuara me lartë dëshmojnë se kemi të bëjmë me Kontrate Publike Kornizë dhe AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK ka qenë i obliguar që këtë aktivitet të prokurimit ta zhvilloj duke përdorur Procedurën : Kontrate Publike Kornize dhe gjithashtu ka qenë i obliguar që të përdorë Formularin B28- Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike Kornizë – Shërbim - Me Një Operator Ekonomik - Procedure e Hapur.

Autoriteti Kontraktues në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka specifikuar në Njoftimin për Kontrate e as në Dosje të Tenderit se është duke përdorur Procedurën - Kontrate Publike Kornizë dhe krejtësisht në mënyrë të gabuar për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit ka përdorur Formularin B16- Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur.

Të gjitha këto fakte dhe argumente i kemi cekur edhe në Kërkesën tone për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK me datën 29.12.2025, por Zyrtaret Përgjegjës të AK gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, qëllimisht nuk i kanë trajtuar fare faktet që kanë të bëjnë me përdorimin e gabuar të Formularin B16-Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur në vende që të përdorë Formularin B28- Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike Kornizë – Shërbim - Me Një Operator Ekonomik - Procedure e Hapur, por janë marre vetëm me pjesën që ka të bëjë me përshkrimin në Listën e Çmimeve.

Formulari B28 – Dosja e Tenderit - Kontrate Publike Kornizë – Shërbim - Me Një Operator Ekonomik - Procedure e Hapur ka dallimi më Formularin B16- Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur, posaçërisht ka dallimet substanciale të përshkrimi i dispozitave - neneve që rregullojnë kushtet e kontratës :

Të Formulari B28 – Dosja e Tenderit - Kontrate Publike Kornizë – Shërbim - Me Një Operator Ekonomik - Procedure e Hapur, kemi:

PJESA B: DRAFT KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

Të Formularin B16- Dosja e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur, kemi:

Hapur, kemi:

PJESA B:Draft KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS- DRAFT KONTRATA

PJESA II E KONTRATES- KUSHTET E PËRGJITHSHME

PJESA III E KONTRATES- KUSHTET E VEÇANTA

Të Formulari B28 – Dosja e Tenderit - Kontrate Publike Kornizë – Shërbim - Me Një Operator Ekonomik - Procedure e Hapur të PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, shenon:

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje.

P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

Të Formularin B16- Dosja e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur të PJESA I E KONTRATËS- DRAFT KONTRATA

shenon:

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

Bazuar në këto të dhëna të shënuara me lartë, shihet së përshkrimi në Formularin B28 dhe përshkrimi në Formularin B16 ka ndryshime substanciale për faktin Zyrtaret e AK-MINISTRISË SË KULTURES RS DHE ÇJK, as në Formularin e gabuar që kane përdorur - B16- Dosja e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur, nuk kane shënuar - plotësuar asnjë nga kushtet e kontratës të PJESA I E KONTRATËS- DRAFT KONTRATA dhe PJESA III E KONTRATES- KUSHTET E VEÇANTA që janë të dhëna substanciale që të gjithë Operatoret Ekonomik duhet ti dine para së të ofertojnë.

Këto veprime të Autoritetit Kontraktues dhe këto shkelje substanciale të legjislacionit të prokurimit publik siç janë, përzgjedhja e gabuar e Procedurës së Prokurimit, përdorimi i gabuar i Dosjes së Tenderit dhe hartimi jo profesional i Dosjes së Tenderit, automatikisht e bëjnë të pamundur vazhdimin e mëtejme të këtij aktiviteti të prokurimit për faktin së bazuar në legjislacionin e prokurimit publik nuk ka mundësi të korrigjimit të procedurës së prokurimit e as të ndryshimit komplet të Dosjes së Tenderit pa bere anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe fillimit të një aktiviteti të ri të prokurimit.

2.Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të

ndryshohen. Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë tridhjetë përqind (30%)). pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

3. Autoriteti kontraktues mund shpërblejë një kontratë publike kornizë kur ka në plan të shpërblejë disa kontrata identike gjatë periudhës që do të përfshihet nga kontrata publike kornizë, dhe konkluzioni i një kontrate publike kornizë që mbulon kontratë të tilla do të reduktonte shpenzimet e prokurimit dhe administrimit të autoriteteve kontraktuese përkatëse

Pretendimi 2:

Shkelje nenit 44 dhe 46 të LPP si dhe shkelje e neni 20 të RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, këtë aktivitet të prokurimit është duke e zhvilluar në kundërshtim të plote me nenin 44 dhe 46 të LPP dhe nenit 20 të RRPP NR.002/2024 për Prokurim Publik për faktin se nuk e ka respektuar nenin 40 të LPP dhe nenin 20 të RRPP 002 /2024 për Prokurim Publik që parashohin që për kontratat me vlera të mëdha afati minimal për tenderim është 40 dite dhe gjithashtu nuk ka respektuar nenin 46 të LPP për faktin se nuk janë plotësuar kushtet për shkurtim të afatit të tenderimit.

Faktet dhe argumentet së pse ne konsiderojmë kështu janë:

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në Njoftimin për Kontrate ka shënuar :

Në nenin IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

X PO JO

Nëse po, jep arsyetim Për shkak se është shpenzuar kontrata e kaluar dhe është e domosdoshme kontrata

Ky arsyetim i shënuar në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit nuk qëndron , për faktin se Kontrata e kaluar që është nënshkruar në mes të AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK dhe kompanisë AS TRAVEL CLUB SH.P.K me datën 30.11.2023 ka validitet deri me datën 30.11.2026. Sipas kësaj kontrate është parapare numri biletave 2,000 cope dhe vlera 710.020.00 €. Në Aneksi nr. 1 i Dosjes së Tenderit dhe Lista e Çmimeve shënon “ Kontrata konsiderohet e realizuar në bazë të sasive të biletave dhe jo vlerës.”

Deri në datën e publikimit të Njoftimit për Kontrate numri i biletave që është realizuar sipas kësaj kontrate është 1 383 bileta. Bazuar në këto të dhëna shihet se numri i biletave të pa porositura MKRS është 617 bileta dhe bazuar në dinamiken e porositjeve gjatë dy vitet paraprake

ku mesatarisht janë porositur 55 bileta ne muaj, konstatohet se kontrata aktuale është valide edhe 11 muaj si nga aspekti kohor asht edhe nga numri i biletave të pa porositura.

Kalkulimi: (1,383/ 25 muaj= 55 bileta mesatarja. 617 bileta te pa porositura / 55 bileta = 11 muaj).

Të gjitha këto fakte dhe argumente i kemi cekur edhe në Kërkesën tone për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK me datën 29.12.2025, por Zyrtaret Përgjegjës të AK gjate shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, e kane interpretuar tërësisht gabim kushtet e Kontratës së nënshkruar në mes të AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK dhe kompanisë tone AS TRAVEL CLUB SH.P.K me datën 30.11.2023 , pasi që ne përgjigje kane shënuar se “ kontrata përfundon ne 3 forma, me realizimin të vlerës, më realizim të sasive dhe aftit kohor.”

Është fakt që sipas legjislacionit të prokurimit publik duhet të jete kështu, por fatkeqësisht Zyrtaret e AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK këto tri kushte nuk i kane pasur të shënuara në Dosjen e Tenderit të datës 05.10.2023, as në Aneksin nr.1 të Dosjes së Tenderit të datës 05.10.2023 e as në përshkrimin e Listës së Çmimeve. Në të gjitha këto dokumente aktivitetit me numër të prokurimit 207-23-10336-211 të datës 05.10.2023 kane pasur të shënuar:

PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA dhe PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA, i ka lenë të pa plotësuar

Ne Aneksin Nr. 1 te DT ka shënuar:

Gjatë periudhës 3 vjeçare numri i përafërt i biletave do të jetë 2000 copë në destinacione të ndryshme të botës. Kontrata konsiderohet e realizuar në bazë te sasive të biletave dhe jo vlerës.

Në përshkrimin e Çmimeve ka shënuar:

Sqarim:*

Vlera e biletës prej € 355.00 është një vlerë e paragjykuar që shërben vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës. Çmimi real do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm ose sisteme online. Kontrata do te bazohet në sasi.

Në Kontratën e datës 30.11.2023 kane shënuar:

1.3. sasi të vlerësuar ,2000 bileta për periudhën 36 muaj e përcaktuar të Lista e Çmimeve, janë sasi inductive. Autoriteti Kontraktues i përmendur ne piken 1.1 është i detyruar të përdore këtë marrëveshje kornize sa here që ka nevojë për shërbimet e përcaktuara.

Duhet theksuar se edhe në Tetorin e vitit 2023, AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit ka përdorur gjithashtu gabim Formularin B16- Dosja e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur dhe për shkak te këtij gabimi kane rrjedhe edhe shume gabime tjera gjate hartimit të kontratës së datës 30.11.2023.

Prandaj arsyetimi i AK për shkurtim të afatit të tenderimit së gjeja “ është shpenzuar kontrata e kaluar dhe është e domosdoshme kontrata” nuk qëndron dhe është në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht me nenin 44 dhe 46 të LPP si dhe nenin 20 të

RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Pretendimi : 3

Shkelje nenit 51 të LPP si dhe shkelje e neni 25 të RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe nenit 20 të Ligjit të Punës-Nr.02/L-212.

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, këtë aktivitet të prokurimit është duke e zhvilluar në kundërshtim të plote më nenin 51 të LPP dhe nenit 25 të RRPP NR.002/2024 për Prokurim Publik për faktin që në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit ka kërkuar (vendosur) kritere që nuk janë në proporcion me këtë aktivitet të prokurimit, konkretisht nuk janë në proporcion me numrin e punëtorëve të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë të trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA). kur kihet parasysh që është kërkuar që shërbimet të kryhen në 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

Faktet dhe argumentet që pse në konsiderojmë kështu janë:

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në Njoftimin për Kontrate të neni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional dhe Dosje të Tenderit të neni 9.1&9.2 , ka shënuar

Kërkesat 1. Operatori ekonomik duhet të ketë së paku 1 (një) punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë të trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA) dhe të kenë minimum 6 muaj përvojë pune.

Në Aneksin nr. 1 të Dosjes së Tenderit ka shënuar:

4.Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë në gjendje të sigurojë shërbimet e lartpërmendura, duke përfshirë ofrimin e aviobiletave në çdo kohë 24/7. (që nënkupton edhe gjatë fundjavëve dhe festave).

5.Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë në gjendje për të garantuar Shërbime 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë dhe duke ofruar emrat e personave të kontaktit, emailat dhe numrin e telefonit kjo do të jetë si kusht pas nënshkrimit të kontratës (kjo është një kërkesë e detyrueshme).

Bazuar në këto kërkesa të Autoritetit Kontraktues shihet që është e pamundur që vetëm një punëtorë i kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve që është i trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror IATA të kryej me sukses shërbimet që ka kërkuar AK, 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë.

Kërkesa për vetëm një punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve që është i trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror IATA, është kërkesë jo profesionale dhe jo në proporcion me aktivitetin e prokurimit.

Kjo kërkesë gjithashtu është edhe në kundërshtim të plote me nenin 20 të Ligjit të Punës-Nr.02/L-212 ku saktësisht e specifikon se orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë.

Zyrtaret e AK- MINISTRISË SË KULTURES RS DHE ÇJK, në përgjigjen – Vendimin e refuzimit të Kërkesës tone për Rishqyrtim kane shënuar se “ Operatoret Ekonomik mund të ankohet për një kriter i cili mund të jete diskriminues, por jo që të ankohet që i njëjti kriter është i cili hap tregun ,hap mundësinë e ofertimi, e mbi hapjen e

mundësisë së ofertimit dhe hapjes se tregut , Autoriteti Kontraktues merre Çmimin me te mire tregut ofertim”.

Edhe ky konstatim i Zyrtareve të AK, shpërfaqë jo profesionalizimin e tyre për faktin së këta zyrtare konsiderojnë së një kriter që duhet të jete proporcionale me aktivitetin e prokurimit (ne satin konkret minimum 3 punëtor të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve që është i trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror IATA së në Aneksin nr, 1 të DT është kërkuar që shërbimet të kruhen 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë), këta e konsiderojnë diskriminim.

Si ka mundësi që vetëm një punëtor i kualifikuar që është i trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror IATA të kryej shërbimet 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë.

Për tu realizuar me sukses kontrata dhe për tu zbatuar neni 20 i Ligjit të Punës-Nr.02/L-212, Zyrtaret Përgjegjës të AK ose duhet të zvogëlojnë kohen e kryerjes së shërbime në 5 dite në javë dhe 8 ore në dite ose të ndryshojnë Kërkesën nr.1 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional dhe të rrisin numrin punëtorëve ne minimum 3 punëtor të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve që janë trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror IATA.

Prandaj bazuar në këto të dhëna që cekem me larte shihet së çdo kompani për ti kryer shërbimet me sukses sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë dhe respektim të nenit 20 i Ligjit të Punës-Nr.02/L-212 duhet ti ketë minimum tre (3) punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve që është i trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror IATA.

Përshkrim i nenit 20 të Ligjit të Punës-Nr.02/L-212

Përcaktimi i orarit të punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit.
2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
3. Orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë (30) orë në javë

Bazuar në faktet dhe argumentet e shënuar me larte kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që Ankesën tone ta konsideroj si të bazuar dhe të marre vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit pasi që AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK ka bere shkelje të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik dhe lëshime substanciale të cilat AK i ka bere gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk mund të korrigjohen në këtë fazë pa bere anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe fillimin e një aktiviteti te ri te prokurimit.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigje – Pretendimi / Ankesa 1:

Refuzohet!

Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën e vendosjes së çmimit dhe, në këtë rast, ka vendosur shumën 355 euro si çmim mesatar, vetëm me qëllim të orientimit të vlerës financiare. Jemi të vetëdijshëm se as Autoriteti Kontraktues dhe as AS Travel nuk i vendosin çmimet, pasi që çmimet vendosen nga tregu, itinerari dhe destinacioni. Megjithatë, vlera financiare 355 euro është një çmim korrespondent për orientimin në vlerën e përgjithshme të kontratës.

Asnjë shkelje nuk ka ndodhur dhe as nuk do të ndodhë në procedurën në fjalë. Vlera financiare, shërbimi i kontratës, kontrata kornizë, detajet e kontratës dhe të gjitha detajet tjera janë të përcaktuara në kontratë, pasi që të njëjtat janë publikuar në platformën elektronike e-prokurimi, në Njoftimin për Kontratë dhe në Formularin e Dosjes së Tenderit.

Përgjigje – Pretendimi / Ankesa 2:

Refuzohet!

Çështja në fjalë nuk përbën bazë për ankesë, pasi që bëhet fjalë për një kontratë në fuqi dhe kontratat në fuqi nuk mund të prekin apo të ndikojnë në procedurën aktuale. Ju jeni njoftuar përmes e-mailit zyrtar se vendosja e një procedure të re nuk nënkupton përfundimin e kontratës ekzistuese.

Kontrata përfundon në tri forma: me realizimin e vlerës, me realizimin e sasive ose me përmbushjen e afatit kohor. Cilido rast që plotësohet, Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën e plotë për përfundimin e kontratës. Andaj, ndërlidhja që ju bëni ndërmjet një kontrate që keni në fuqi dhe një procedure të re përbën tendencë për shkelje dhe ndikim, gjë që në asnjë formë Autoriteti Kontraktues nuk e lejon.

Përgjigje – Pretendimi / Ankesa 3:

Refuzohet!

Operatori Ekonomik mund të ankohet për një kriter që mund të jetë diskriminues, por jo të ankohet se i njëjti kriter hap tregun dhe krijon mundësi për ofertim. Pikërisht përmes hapjes së mundësisë së ofertimit dhe të tregut, Autoriteti Kontraktues siguron çmimin më të mirë.

Në këtë formë, i gjithë pretendimi ankimor është i pabazuar dhe mbesin në fuqi të gjitha kriteret, afatet dhe njoftimet e vendosura në platformën elektronike.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.01.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0008, ndërsa me datë 23.01.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0008, me rekomandimet si në vijim. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që ankesa e Operatori Ekonomik ankues, “AS TRAVEL CLUB” SH.P.K. , Prishtinë është **pjesërisht e bazuar**, njëherësh propozoj që të bëhen anulimi i aktivitetit të prokurimit - **ritender**.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0008 ka vlerësuar si në vijim:

Operatori Ekonomik Ankues, (**"AS TRAVEL CLUB" SH.P.K. , Prishtinë**), ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 29.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të publikuar nga AK-së, përderisa AK me datë 30.12.2025 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Operatori Ekonomik Ankues, deklaroi se nuk pajtohet me Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri shqyrtim nga AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, andaj në pajtueshmëri me *Nenin 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092* me datë 05.01.2026 ka parashtrua ankesë në OSHP me pretendimet e njëjta se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së me rastin e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas Operatori Ekonomik ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

Neni - 27 - Dosja e Tenderit

Neni - 38 Kontratat Publike Kornizë

Neni - 44 Rregullat e Përgjithshme mbi Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje

Neni - 46 - Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore

Neni - 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Shkeljet e dispozitave të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

(RRPP) janë:

Neni - 17- Dosja e Tenderit

Neni - 20 - Afate kohore të fazës së tenderimit

Neni - 25- Kriteret e përzgjedhjes

Neni - 54 - Kontratat Kornizë

Shkeljet e dispozitave të Ligjit të Punës-Nr.02/L-212

Neni - 20- Përcaktimi i orarit të punës

Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2026/0008, pas ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit të publikuar nga AK dhe rrjedhës së tenderimit, pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkruesat e lëndës së trajtuar **ka konstatuar dhe sqaron për pretendimet me sa vijon:**

Pretendimi 1:

OE ankues ("AS TRAVEL CLUB" SH.P.K. , Prishtinë) mendon dhe pretendon se me rastin e shpalljes së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka bërë shkelje të nenit 27 dhe 38 të LPP si dhe shkelje të neni 17 dhe 54 të RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK këtë aktivitet të prokurimit është duke e zhvilluar në kundërshtim të plotë me nenin 27 dhe 38 të LPP dhe nenit 17 dhe 54 të RRPP NR.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK, të cilat pretendime ankimore i ka radhitur në këtë ankesë të cekura dhe numëruara më lartë.

Përgjigje në P R E T E N D I M E T Numër – 1 të OE ankues:

Eksperti shqyrtues pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të Operatorit Ekonomik të AK me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë dhe DT ka bërë shkelje substanciale të dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, konkretisht pohimit se ka bërë shkelje të nenit 27 të LPP-së (*Dosja e Tenderit*), konstaton se qëndrojnë këto pretendime. AK, e ka ngatërruar procedurën e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Në sistemin elektronik E-prokurimi AK ka ngarkuar Formularin B16- Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur, që është gabim procedural sepse në përshkrimin e kontratës në Njoftimin për kontratë dhe në Dosje të tenderit ka shënuar si vijon:

Me këtë përshkrim të cituar më lartë AK ka dëshmuar se ka të bëjë me Kontratë Publike Kornizë dhe është dashtë në këtë aktivitet të prokurimit ta zhvilloj duke përdorur metodën e prokurimit

- *Kontrate kornize me një operator ekonomik-nëse qëllimi është përmbyllja me kontrate kornize me një operator ekonomik*

Andaj, AK është dashtë që gjatë përgatitjes dhe publikimit të procedurës ta krijoj dosjen e tenderit dhe dokumentacionit tjetër në baze të dhënave të futura në hapat e mëparshëm, e që është *Formularin B28- Dosja e Tenderit - Kontrate Publike Kornizë – Shërbim - Me Një Operator Ekonomik - Procedure e Hapur*.

Dosja e tenderit e ngarkuar me *Formularin B16- Dosjen e Tenderit - Kontrate Publike - Shërbime – Procedurë e Hapur*, është në kundërshtim me qëllimin e kontratës, sepse sipas kësaj

DT Tenderuesi duhet të ofrojë **tërësinë e sasisë ose të sasive të shënuara për secilën pjesë**, e nuk e jep mundësinë sikur **Kontrata publike kornizë** të DRAFT Kontrata Neni 1:

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të përformohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

Eksperti shqyrtues pajtohet me pretendimet e OE ankues se këto veprime të Autoritetit Kontraktues dhe këto shkelje substanciale të legjislacionit të prokurimit publik siç janë, përzgjedhja e gabuar e Procedurës së Prokurimit, përdorimi i gabuar i Dosjes së Tenderit dhe hartimi jo profesional i Dosjes së Tenderit, automatikisht e bëjnë të pamundur vazhdimin e mëtejme të këtij aktiviteti të prokurimit për faktin se bazuar në legjislacionin e prokurimit publik nuk ka mundësi të korrigjimit të procedurës së prokurimit e as të ndryshimit komplet të Dosjes së Tenderit pa e bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe fillimit të një aktiviteti të ri të prokurimit.

Eksperti shqyrtues e vlerëson të bazuar pretendimin se AK e ka shkelur Nenin 38 të LPP-së (*Kontratat Publike Kornizë*) paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni dhe Neni 54 i RREGULLORES NR.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores NR. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku AK është dashtë me rastin e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit për **Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse**, të veprojnë në pajtueshmëri me Kontratën publike Kornizë e jo si ka vepruar duke e publikuar dhe ngarkuar DT Kontratë Publike-shërbime.

Eksperti shqyrtues vlerëson se, lidhur me procedurën e rishqyrtimit, nga dokumentacioni i lëndës rezulton se kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik është refuzuar pa bazë të mjaftueshme ligjore, pavarësisht faktit se aktiviteti i prokurimit ishte pezulluar paraprakisht nga AK. Në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, AK ka anashkaluar faktet dhe argumentet thelbësore të paraqitura në kërkesën e datës 29.12.2025, duke mos i trajtuar në mënyrë të drejtë shkeljet e pretenduara dhe pa ofruar arsyetim të qartë e të mjaftueshëm ligjor lidhur me mënyrën dhe metodologjinë e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Në përfundim, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues janë të bazuara dhe se aktiviteti i prokurimit nuk mund të vazhdojë në këtë formë, për shkak të shkeljeve të konstatuara, andaj sipas ekspertit shqyrtues vlerësohet i domosdoshëm anulimi i aktivitetit të prokurimit dhe inicimi i një procedure të re, në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

Pretendimi 2:

OE ankues (“AS TRAVEL CLUB” SH.P.K. , Prishtinë) mendon dhe pretendon se me rastin e shpalljes se këtij aktiviteti të prokurimit Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, këtë aktivitet të prokurimit është duke e zhvilluar në kundërshtim të plote me nenin 44 dhe 46 të LPP dhe nenit 20 të RRPP NR.002/2024 për Prokurim Publik për faktin se nuk e ka respektuar

nenin 40 të LPP dhe nenin 20 të RRPP 002 /2024 për Prokurim Publik që parashohin që për kontratat me vlera të mëdha afati minimal për tenderim është 40 dite dhe gjithashtu nuk ka respektuar nenin 46 të LPP për faktin se nuk janë plotësuar kushtet për shkurtime të afatit të tenderimit.

Përgjigje në P R E T E N D I M E T Numër – 2 të OE ankues:

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit të publikuara në platformën E-prokurimi për “Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse”, **pjesërisht pajtohet** me pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues dhe vlerëson se AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 44 dhe 46 të LPP-së, si dhe me nenin 20 të RRPP Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik.

Nga shqyrtimi i Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit rezulton se AK ka aplikuar shkurtime të afatit të tenderimit për një kontratë me vlerë të madhe, duke u arsyetuar se “është shpenzuar kontrata e kaluar dhe është e domosdoshme kontrata”.

Ky arsyetim nuk qëndron, pasi nga faktet e paraqitura dhe dokumentacioni përkatës rezulton se kontrata ekzistuese, e nënshkruar më datën 30.11.2023, është valide deri më 30.11.2026 dhe ende nuk janë realizuar të gjitha sasishtet e parashikuara të biletave, pasi që në kontratën me numër: 207-23-10336-2-1-1/C328 e datës 30.11.2023 të PJESA III e Kontratës Kushte e veçanta shënon klauzola plotësuese me nr. 22.1

Gjatë periudhës 3 vjeçare numri i përafërt i biletave do të jetë 2000 copë në destinacione të ndryshme të botës dhe kjo mund të ndryshojë sipas legjislacionit në fuqi +/- 30%.

Nga ajo që shkruan më lartë, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shkurtime të afatit të tenderimit, siç parashihet në nenin 46 të LPP-së, ndërkohë që nuk është respektuar as afati minimal prej 40 ditësh për kontrata me vlera të mëdha, sipas nenit 44 të LPP-së dhe nenit 20 të RRPP Nr. 002/2024.

Po ashtu, eksperti shqyrtues vlerëson se AK, edhe gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka interpretuar gabimisht kushtet e kontratës ekzistuese, duke pretenduar se kontrata përfundon me realizimin e vlerës, sasive ose afatit kohor, ndonëse këto kushte kanë qenë të përcaktuara në mënyrë të qartë të kontratës me numër: 207-23-10336-2-1-1/C328, në PJESA III e Kontratës Kushte e veçanta shënon klauzola plotësuese me nr. 22.1. u *(Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK)*. Kjo tregon mungesë të formulimit të drejtë dhe të qartë në dokumentacionin e prokurimit, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Eksperti shqyrtues gjatë kërimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit në platformën elektronike E-prokurimi ka konstatuar se të njëjtat veprime të gabuara me rastin e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit *(përzgjedhja e gabuar e Procedurës së Prokurimit, përdorimi i gabuar i Dosjes së Tenderit)* i ka bërë AK në vitin 2023, të cilat është

dashtë ti evitoj me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse**, me nr. të prokurimit: 207-25-11429-2-1-1

Në përfundim, eksperti shqyrtues konstaton se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për shkurtimin e afatit të tenderimit **është pjesërisht i bazuar**, nëse i ka bërë kalkulimet e duhura dhe të argumentuara në pajtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht me nenet 44 dhe 46 të LPP-së dhe nenin 20 të RRPP Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, duke planifikuar se deri në përzgjedhjen e kontraktuesit të ri për këtë shërbim nuk i ka mbetur kohë e mjaftueshme për përdorimin e afateve normale të tenderimit.

Pretendimi 2:

OE ankues (“AS TRAVEL CLUB” SH.P.K. , Prishtinë) mendon dhe pretendon se me rastin e shpalljes se këtij aktiviteti të prokurimit Autoriteti Kontraktues – ka bërë s

Autoriteti Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, këtë aktivitet të prokurimit është duke e zhvilluar në kundërshtim të plote më nenin 51 të LPP dhe nenit 25 të RRPP NR.002/2024 për Prokurim Publik për faktin se në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit ka kërkuar (vendosur) kritere që nuk janë në proporcion me këtë aktivitet të prokurimit, konkretisht nuk janë në proporcion me numrin e punëtorëve të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë të trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA). kur kihet parasysh që është kërkuar që shërbimet të kryhen në 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë gjatë tere periudhës së realizimit të kontratës.

Përgjigje në P R E T E N D I M E T Numër – 3 të OE ankues:

(Shkelje e nenit 51 të LPP-së, nenit 25 të RRPP Nr.002/2024 për Prokurimin Publik dhe nenit 20 të Ligjit të Punës Nr.02/L-212)

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit për këtë shërbim pajtohet me pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues dhe vlerëson se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 51 të LPP-së dhe nenin 25 të RRPP Nr.002/2024 për Prokurimin Publik, duke vendosur kritere të kapacitetit teknik dhe profesional që nuk janë proporcionale me natyrën dhe shtrirjen e këtij aktiviteti të prokurimit.

Nga Njoftimi për Kontratë dhe DT rezulton se AK ka kërkuar që shërbimet të ofrohen 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë, ndërkohë që njëkohësisht ka përcaktuar si kriter minimal posedimin e vetëm një (1) punëtori të kualifikuar, të trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (IATA). Ky kriter është në mospërputhje të qartë me kërkesat operative të kontratës dhe nuk garanton kapacitet real për ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të kërkuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për vetëm një punëtor të kualifikuar IATA nuk është profesionale dhe as proporcionale me aktivitetin e prokurimit, pasi realizimi i shërbimeve 24/7 gjatë gjithë vitit objektivisht kërkon angazhimin e më shumë se një personi. Për më tepër, një kërkesë e tillë bie ndesh edhe me nenin 20 të Ligjit të Punës Nr.02/L-212, i cili përcakton se orari i plotë i punës është 40 orë në javë, duke e bërë të pamundur që një punëtor i vetëm të mbulojë kërkesat e kontratës pa shkelur dispozitat e këtij ligji.

Gjithashtu, arsyetimi i AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, se kriteri i vendosur “hap tregun” dhe nuk është diskriminues, nuk qëndron. Vendosja e kriterëve proporcionale dhe reale nuk përbën diskriminim, por është detyrim ligjor i AK për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe zbatim të realizueshëm të kontratës. Në rrethanat konkrete, përmbushja e kërkesave të DT do të kërkonte mos tre (3) me sistemim orari me menaxherin së paku dy (2) punëtorë të kualifikuar IATA, në mënyrë që të sigurohet ofrimi i shërbimeve në vazhdimësi dhe në përputhje me Ligjin e Punës.

Në përfundim, eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 51 të LPP-së, nenin 25 të RRPP Nr.002/2024 për Prokurimin Publik dhe nenin 20 të Ligjit të Punës Nr.02/L-212, duke vendosur kriterë jo proporcionale dhe të pazbatueshme në praktikë. Për pasojë, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues **vlerësohet i bazuar**.

Konkluzion përfundimtar

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit dhe analizimit të pretendimeve të Operatorit Ekonomik ankues, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i parë dhe i tretë janë të bazuara kurse pretendimi i dytë pjesërisht i bazuar. AK ka bërë shkelje substanciale të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloreve përkatëse, duke bërë përzgjedhjen dhe publikimin e gabuar të procedurës së prokurimit, shkurtimin e paarsyetuar të afatit të tenderimit, si dhe vendosjen e kriterëve jo proporcionale dhe të pazbatueshme të kapacitetit teknik dhe profesional, në kundërshtim edhe me Ligjin e Punës. Këto shkelje, për nga natyra dhe pesha e tyre, nuk mund të korrigjohen në këtë fazë procedurale, andaj aktiviteti i prokurimit nuk mund të vazhdojë më tej në këtë formë, duke u bërë i domosdoshëm anulimi i aktivitetit të prokurimit dhe inicimi i një procedure të re, në përputhje të plotë me LPP-në dhe RREGULLOREN Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, (Versioni i Konsoliduar).

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse me numër të prokurimit 207-25-11429-2-1-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ja fal besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues që ky aktivitet të anulohet në tërësi. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet ky aktivitet ne teresi dhe kthehet ne ritenderim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që

ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: